



Udhëzimet e përdorimit

—
NexxZr.[®] S
NexxZr.[®] T
NexxZr.[®] T Multi
NexxZr.[®] +
NexxZr.[®] + Multi

Tabela e përmbajtjes

Karakteristikat materiale	03
Të dhënat teknike	03
Skeda e të dhënave të sigurisë (SDS)	04
Garancia/magazinimi	04
Vendosja/Modelimi dhe frezimi	05
Infiltrimi	05
Trashësitë minimale të shtresës dhe përmasat e konektorit	06
Rekomandimet për sinterizimin	08
Rëra me presion/paspërpunimi	09
Veshja me porcelan/ngjyrosja dhe glazura	09
Cementimi	10

Karakteristikat materiale

Disqet "NexxZr®" përbëhen nga oksid zirkoni (Y-TZP ZrO₂) për përdorime në stomatologji. Ky material është krijuar në mënyrë specifike për prodhimin e protezave të përhershme dentare. Te përdorimet përfshihen: Urat dhe kurorat anteriore dhe posteriore, koronat teleskopike me formë konike. Pas përfundimit të sinterizimit të specifikuar përfundimtar i gjithë zirkoni "Sagemax NexxZr" plotëson kërkesat e EN ISO 6872.

Të dhënat teknike

Përbërja

Materiali	NexxZr S	NexxZr T	NexxZr T Multi	NexxZr+	NexxZr+ Multi
Oksid zirkoni (ZrO ₂)	≥ 89,0%	≥ 89,0%	≥ 88,0%	≥ 85,0%	≥ 86,0%
Oksid itriumi (Y ₂ O ₃)	4,0-6,0%	4,0-6,0%	4,5-7,0%	7,0-9,0%	6,5-8,0%
Oksid hafniumi (HfO ₂)	≤ 5,0%	≤ 5,0%	≤ 5,0%	≤ 5,0%	≤ 5,0%
Oksid alumini (Al ₂ O ₃)	≤ 1,0%	≤ 1,0%	≤ 1,0%	≤ 1,0%	≤ 1,0%
Okside të tjera	≤ 1,0%	≤ 1,0%	≤ 1,5%	≤ 1,0%	≤ 1,0%

Karakteristikat

Materiali	NexxZr S	NexxZr T	NexxZr T Multi	NexxZr+		NexxZr+ Multi
				e bardhë me nuancë		
Zgjerimi linear termik / CTE (25-500 °C) (10 ⁻⁶ K ⁻¹)	10,6 ± 0,5	10,6 ± 0,5	10,5 ± 0,5	10,1 ± 0,5		10,4 ± 0,5
Rezistenca në përkulje (MPa) ¹	1370	1270	630 (incizal) 1170 (dentinë)	1000	880	630 (incizal) 880 (dentinë)
Rezistenca ndaj thyerjes (MPa*m ^{1/2}) ¹	≥ 5,0	≥ 5,0	≥ 5,0 (dentinë)	≥ 3,5	≥ 3,5	≥ 3,5 (dentinë)
Tejdukshmëria (1-CR)*100 ²	30%	42%	49% (incizal) 42% (dentinë)	46%	46%	49% (incizal) 46% (dentinë)
Tretshmëria kimike (µg/cm ²)	< 100	< 100	< 100	< 100		< 100
Lloji/klasa	Lloji II / klasa 5	Lloji II / klasa 5	Lloji II / klasa 5	Lloji II / klasa 5	Lloji II / klasa 4	Lloji II / klasa 4

¹ vlerat e zakonshme sipas ISO 6872 (kampioni i polishuar)

² disqet me nuancë tregojnë vlera më të ulëta

Skeda e të dhënave të sigurisë (SDS)

Përbërësit e rrezikshëm

Oksid zirkoni	
Numri CAS	1314-23-4
Përqindja	91 - 96%
ACGIH TLV	5 (T)
OSHA PEL	5 (T)
Njësitë	mg/m ³
Oksid itriumi	
Numri CAS	1314-36-9
Përqindja	4 - 9%
ACGIH TLV	5 (T)
OSHA PEL	5 (T)
Njësitë	mg/m ³

Të dhënat e rrezikut për shëndetin

Format e ekspozimit:

- X Kontakt me lëkurën
- N/A Përthithje nga lëkura
- X Kontakt me sytë
- X Frymëmarrje akute
- X Frymëmarrje kronike
- X Gëlltitje

Procedurat e urgjencës dhe të ndihmës së shpejtë

- › **Frymëmarrje:** Nëse zhvillohen simptoma ku merr pjesë mushkëria (kollitje, dihatje, mosmbushje me frymë etj.) largojuni ekspozimit dhe kërkoni kujdesin mjekësor.
- › **Kontakt me lëkurën/sytë:** Nëse ka irrim, shpëlajeni me ujë të bollshëm. Nëse irrimin vazhdon, kërkoni kujdesin mjekësor.
- › **Gëlltitje:** Nëse kapërdihen sasi të konsiderueshme, hollojeni me ujë të bollshëm. Provokoni të vjella dhe kërkoni kujdesin mjekësor.

Garancia/magazinimi

Garancia

- › Informacioni teknik dhe rekomandimet e përdorimit, qoftë kur jepen gojarisht, qoftë kur jepen me shkrim, si dhe trajnimi praktik janë të gjitha direktiva.
- › Furrat e sinterizimit ndryshojnë në performancë. Është tejet e rëndësishme që furrat të kalibrohen rregullisht për të pasur rezultate optimale. Ndiqni udhëzimet e kalibrimit sipas rekomandimeve të prodhuesit.
- › Produktet tona janë në zhvillim dhe përmirësim të vazhdueshëm. Do t'ju këshillojmë për ndryshime të tilla.
- › Ne punojmë për të ofruar produkte të cilësisë maksimale. Kur ta merrni produktin inspektojeni për defekte të dukshme përpara frezimit.
- › Pasi disqet dhe blloqet të jenë frezuar pjesërisht, cdo pretendim dhe ankese konsiderohet i pavlefshëm.

Ruajtja

Ruajeni të gjithë zirkonin "NexxZr" në paketimin fillestar në një ambient të thatë në temperaturë normale dhome.

Vendosja/Modelimi dhe frezimi

Indikacionet

Indikacionet	NexxZr S	NexxZr T	NexxZr T Multi	NexxZr+		NexxZr+ Multi
				e bardhë	me nuancë	
Restaurime me njësi të vetme (anteriore/posteriore)	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Ura me 3 njësi (anteriore/posteriore)	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Ura me shumë njësi (anteriore/posteriore)	✓	✓	✓	✓	x	x

- › **Vetëm për përdorim në tregun kanadez:** Ura duhet kufizuar në 6 njësi me maksimumi 2 trupa ure.

Kundërintikacionet

- › Mbi 2 trupa ure të njëpasnjëshëm
- › Preparate tepër të thella subgingivale
- › Pacientët me dhëmbë të papërshtatshëm natyralë
- › Bruksizëm
- › Dy a më shumë njësi të njëpasnjëshme me fund të lirë
- › Futje si restaurime të përkohshme
- › Alergji të njohura
- › Higjienë e pamjaftueshme orale
- › Të gjitha përdorimet e tjera nuk përfshihen në indikacione

Modelimi dhe frezimi

- › Ndiqni udhëzimet për softuerin CAD/CAM për skanim dhe modelim restaurimesh.
- › Sistemet e frezimit duhet të kalibrohen për rezultate optimale. Jo të gjitha sistemet janë njësoj dhe për pasojë mund të kenë rezultate negative nëse nuk ruhet trashësia minimale.
- › Për urat, modeloni gjithnjë suporte ndihmëse për të evituar deformimin gjatë sinterizimit.

Infiltrimi

Infiltrimi i restaurimeve "NexxZr" përpara sinterizimit

- › Ndiqni udhëzimet përkatëse për përdorimin e furnizuesit.



PARALAJMËRIM!

- › Përdoruesi duhet të marrë masa kur përdor zirkon të pasinterizuar. Punoni gjithnjë në ambient të ajrosur mire.
- › Përdorni doreza sintetike kur mbani zirkon dhe lëngje të parangjyrosura.
- › Lëngjet e parangjyrosura nuk duhet të bien në kontakt me lëkurën.
- › Rekomandohet të mbani doreza, syze sigurie dhe veshje të përshtatshme mbrojtëse.
- › Përdorni vakuumin e duhur në zonë të mirajrosur për të kapur e bllokuar pluhurat.

Trashësitë minimale të shtresës dhe përmasat e konektorit

Për të arritur sukses nga aspekti klinik, nuk duhen anashkaluar trashësitë e mëposhtme minimale të mureve dhe përmasat e konektorëve gjatë përpunimit të disqeve "NexxZr":

NexxZr S, NexxZr T

Indikacionet	Regjioni anterior		Regjioni posterior	
	Trashësia minimale e shtresës në mm	Përmasat e konektorit në mm ²	Trashësia minimale e shtresës në mm	Përmasat e konektorit në mm ²
Këllëfët	0,4	-	0,6	-
Urat me 3 njësi	0,6	7	0,6	9
Urat me shumë njësi me 2 trupa ure	0,6	9	0,7	12*
Ura me fund të lirë me një trup ure	0,7	12*	0,7	12*

NexxZr T Multi

Indikacionet	Regjioni anterior		Regjioni posterior	
	Trashësia minimale e shtresës në mm	Përmasat e konektorit në mm ² ***	Trashësia minimale e shtresës në mm	Përmasat e konektorit në mm ² ***
Restaurime të plota ose të pjesshme anatomike				
Këllëfët	0,8	-	1,0	-
Urat me 3 njësi	1,0	9	1,0	9
Urat me shumë njësi me 2 trupa ure	1,0	9	1,0	12*
Ura me fund të lirë me një trup ure	1,0	12*	1,0	12*
Skeletet, parakushtet: pozicionim i plotë në zonën e dentinës				
Këllëfët	0,4	-	0,6	-
Urat me 3 njësi	0,6	9	0,6	9
Urat me shumë njësi me 2 trupa ure	0,6	9	1,0	12*
Ura me fund të lirë me një trup ure	1,0	12*	1,0	12*

NexxZr+

Indikacionet	Regjioni anterior				Regjioni posterior			
	Trashësia minimale e shtresës në mm		Përmasat e konektorit në mm ²		Trashësia minimale e shtresës në mm		Përmasat e konektorit në mm ²	
	e bardhë	me ngjyrosje paraprake	e bardhë	me ngjyrosje paraprake	e bardhë	me ngjyrosje paraprake	e bardhë	me ngjyrosje paraprake
Këllëfët	0,8		-		1,0		-	
Urat me 3 njësi	1,0		12*		1,0		16	
Urat me shumë njësi me 2 trupa ure	1,0	-	12*	-	1,0	-	16	-

NexxZr+ Multi

Indikacionet	Regjioni anterior		Regjioni posterior	
	Trashësia minimale e shtresës në mm	Përmasat e konektorit në mm ² ***	Trashësia minimale e shtresës në mm	Përmasat e konektorit në mm ² ***
Këllëfët	0,8	-	1,0	-
Urat me 3 njësi	1,0	12*	1,0	16

* Lartësia: 4 mm, gjerësia: 3 mm

** Në Kanada, indikacionet e për urat janë të kufizuara në 6 njësi me maksimumi 2 trupa të lidhura ure

*** Prerja e përcaktuar minimale tërthore e konektorit duhet pozicionuar në zonën e dentinës së diskut

Rekomandimet për sinterizimin

Furrat e sinterizimit ndryshojnë në performancë. Është tejet e rëndësishme që furrat të kalibrohen rregullisht për të pasur rezultate optimale.

NexxZr S, NexxZr T, NexxZr+

	Numri i njësive	Kohëzgjatja	Faza	Temperatura	Ngrohja / Ftohja	Koha e qëndrimit
		orë		°C	°C/min	min
Standarde	1-5	~3,7	1	20-1300	30	30
			2	1300-1530	40	60
			3	1530-900	15	-
			4	900-80	20	-
	5-10	~5,2	1	20-1300	30	60
			2	1300-1530	40	120
			3	1530-900	15	-
			4	900-80	20	-
E zgjatur	1-20	~10,7	1	20-900	10	10
			2	900-1530	3	150
			3	1530-80	8	-
	>21	~11,7	1	20-900	10	10
			2	900-1530	3	210
			3	1530-80	8	-
Gjatë natës	E pakufizuar	~14,3	1	20-250	2	-
			2	250-1530	4	240
			3	1530-80	8	-

NexxZr+ Multi, NexxZr T Multi

	Numri i njësive	Kohëzgjatja	Faza	Temperatura	Ngrohja / Ftohja	Koha e qëndrimit
		orë		°C	°C/min	min
Shpejtësia	1-5	~4,8	1	20-1000	60	10
			2	1000-1530	3	60
			3	1530-1100	50	-
			4	1100-80	60	-
E zgjatur	E pakufizuar	~9,6	1	20-900	10	30
			2	900-1500	3	120
			3	1500-900	10	-
			4	900-300	8	-

- › Vendosini sendet për tu sinterizuar në profilet e sirtarit të sinterizimit.
- › Lini hapësirë për sendet në sirtar për të ndihmuar ngrohjen me konveksion.
- › Sendet e sinterizuara do të marrin një shkelqim të lehtë.



PARALAJMËRIM!

- › Furrat e sinterizimit duhet të vendosen në zona të ajrosura mire me mbrojtje kundër zjarrit.
- › Ftohja e ngadaltë është thelbësore për rezultatin përfundimtar; mos e ftohni shumë shpejt.
- › Nëse e hapni furrën para kohe mund të shkaktoni plasaritjen e zirkonit.

Rëra me presion/paspërpunimi

Përshtatja e kontureve

Pas sinterizimit përfundimtar, restaurimet me zirkon mund të përshtaten dhe formësohen me anë të frezave të përshtatshme abrazive me diamant.

Përdorni turbinë laboratorike me ftohje me ujë për të parandaluar thyerjen.

Tolerancat mund të ngushtohen duke përdorur rrota abrazive gome të butë, të krijuara posaçërisht për përdorime të tilla.

Rëra me presion

Pas kryerjes së rregullimeve, kurora ose ura duhet të punohet me rërë me presion me oksid alumini 50 µm të bardhë të pastër në afro 2,5 bar.

Ri - sinterizimi

Pas pastrimit me rërë me presion dhe avull, sendet duhet të risinterizohen në furrë porcelani për të izoluar mikrofrakturat që mund të jenë shfaqur gjatë gërryerjes.

Ngrijeni temperaturën në 40°C/min në 1000°C.

Mbajeni në ajër për 5 minuta. Ftoheni me ngadalë në temperaturën e dhomës. Restaurimet janë tani gati për polishim, ngjyrosje dhe glazurë.



PARALAJMËRIM!

- › Gërryerjet mbi zirkon të sinterizuar duhet të kryhen në zona të ajrosura mire.
- › Mos thithni pluhurin e grimcave.
- › Përdorni njësi të përshtatshme vakuumi për thithjen e pluhurit.
- › Përdorni syze sigurie gjatë gërryerjes dhe punimit me rërë me presion.
- › Pastroni me rërë me presion vetëm një njësi të miratuara me vakuum.

Veshja me porcelan/ngjyrosja dhe glazura

Polishimi

- › Sipërfaqes së zirkonit i duhet vendosur një shtresë e hollë porcelani ngjitës, dhe duhet pjekur në furrë porcelani.
- › Aplikoni zir liner sipas nevojës.
- › Ndiqni rekomandimet e prodhuesit për parametrat e pjekjes.
- › Ndiqni informacionin teknik për koeficientin e bymimit termik për zirkonin si dhe për koeficientin e shtresës së porcelanit.

Ngjyrosja dhe glazura

- › Ngjyrosni dhe glazuroni në shtresa të holla për të arritur shkelqimin e preferuar.
- › Përdorni ngjyruer dhe glazura të krijuara për përdorim me zirkon.
- › Përdorni rekomandimet e prodhuesit për parametrat e pjekjes.

Paspërpunimi nga dentisti

Kur nevojiten rregullime okluzale dhe proksimale nga dentisti, rekomandohet të përdoren freza abrazive me diamant për punime të imeta.

Restaurimet duhet të ftohen gjatë procesit të gërryerjes. Niveli i gërryerjes së diamantit duhet të jetë afro 40 mikronë.

Pas gërryerjes, lëmojini sipërfaqet me polishues të rrumbullaket gome dhe lastrojini me pastë lustrimi diamanti 10-mikronësh.

Kini parasysh që nëse restaurimi nuk lustrohet mjaftueshëm, antagonisti mund të pësojë abrazion me kalimin e kohës.

Cementimi

Cementimi konvencional

Karakteristikat origjinale të zirkonit "NexxZr" i japin forcë dhe qëndrueshmëri maksimale. Ndaj fiksimi konvencional me fosfat oksidi zinku apo cement glass jonomer nuk është i mundur në shumicën e rasteve. Pastroni lehtë me rërë me presion brenda restaurimit me oksid alumini 50 mikronësh të bardhë të pastër dhe pastroni me avull përpara cementimit.

Kur përdorni teknikën e zakonshme të cementimit, është e rëndësishme të ndiqni kërkesat e sakta të ngjitjes së abutmentit.

Fiksimi me ngjitës

Cementet ngjitëse krijojnë një lidhje të shkëlqyer midis strukturës së dhëmbëve dhe materialit të skeletit me oksid zirkoni.



Prodhuar nga

Sagemax Bioceramics, Inc.
34210 9th Ave. South, Suite 118
Federal Way, WA 98003, USA
T +1-253-214-0389
E info@sagemax.com

Përfaqësuesi për KE-në

AB Ardent
Generatorgatan 8
19560 Arlandastad, Sweden
T +46 8594 412 57
E info@sagemax.com

sagemax.com

CE 0123

RX only

Vetëm për përdorim stomatologjik.

Materiali është krijuar vetëm për përdorim dentar. Përpunimi duhet kryer duke ndjekur me rreptësi Udhëzimet e Përdorimit. Nuk pranohet asnjë përgjegjësi për dëmtime të shkaktuara nga mosrespektimi i udhëzimeve ose mosaplikimi në zonën e duhur. Është përgjegjësi e përdoruesit që ta testojë materialin për përshtatshmëri dhe përdorim për çfarëdo qëllimi tjetër të paspecifikuar në mënyrë të hapur tek udhëzimet. Përshkrimet dhe të dhënat nuk ofrojnë ndonjë garanci për vetitë dhe nuk janë detyruese.